



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 04.05.2015, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. 1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 01- 22 maj 2015.
3. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Armando Prenga, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

**Mungojnë:**

Armando Subashi, Tom Doshi

**Të ftuar:**

Ketrin Treska – drejtoreshë në Drejtorinë e Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – specialiste në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Përshëndetje!

Meqë formohet kuorumi, fillomë mbledhjen e komisionit.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit.

Ka një sugjerim nga kolegët që ta rishohim për ta përmbledhur më mirë për shkak të ditëve që janë me ngarkesë fushate. Kështu që stafi le të ribëjë një risistemim të kalendarit.

Dakord? Në rregull.

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Nga Ministria e Drejtësisë ka ardhur zonja Ketrin Treska, drejtoreshë në Drejtorinë e Oponencës Ligjore.

Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër të projektit, megjithëse është i njohur për kolegët!

**Ketrin Treska** – Faleminderit!

Ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të Këshillit të Europës, si dhe palëve të tjera kontraktuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky protokoll shërben për mbështetjen nga ana e autoriteteve shqiptare të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe për lehtësimin e mundësive të qytetarëve në ushtrimin e të drejtave dhe interesave të tyre në mënyrën sa më efikase.

Projektligji “Për ratifikimin e protokollit të 16-të të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” propozohet në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm dhe të përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar në konferencën e nivelit të lartë në lidhje me të ardhmen e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të mbajtur në Brighton më 19 dhe 20 prill të 2012-s, deklaratat e miratuara në konferencat e zhvilluara në Interlaken më 18 dhe 19 shkurt të 2010-s dhe Izmir më 26 dhe 27 prill të 2011-s, si dhe opinionin nr. 283 të 2013-s, të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës më 26 prill të vitit 2013, duke pasur nevojën për të siguruar se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mund të vazhdojë të luajë rolin e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë.

Ratifikimi i protokollit të 16-të do të thellojë bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Europës, si dhe palëve të tjera kontraktuese në fushën e të drejtave

dhe lirive themelore të njeriut, njëkohësisht do t'u shërbejë qëllimeve të drejtësisë që shtetasit të gëzojnë një mbrojtjeje më të mirë ligjore.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zonja Hysi, keni fjalën, si relatore e komisionit për këtë çështje.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, protokollin i 16-të i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore është paraqitur në përputhje me kërkesat e Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

Unë dua të ndalem në gjashtë risi që sjell ratifikimi i këtij protokollin. Kjo transparencë nuk është vetëm për qytetarët, por edhe për profesionistët.

Së pari, u jepet mundësia gjykatave më të larta për disa çështje parimore, por ne duhet të përcaktojmë këtu se cilat do të jenë gjykatat më të larta që do të ketë të drejtë të kërkojnë interpretim ose opinione nga Gjykata e Strasburgut në lidhje me zbatimin e lirive dhe të drejtave themelore, të parashikuara në konventë dhe në protokollet shtesë të konventës. Kërkesa duhet të jetë për çështje parimore, jo për çështje rutinë që mund të ketë në praktikën e saj gjykata më e lartë.

Së dyti, diskrecioni i Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila nëpërmjet pesë gjyqtarëve të dhomës së madhe duhet të japë opinion për një çështje që është në shqyrtim në gjykatën më të lartë kombëtare.

Së treti, pjesëmarrja e gjykatave kombëtare në seancat e dhomës së madhe në Gjykatën e Strasburgut.

Së katërti, komisionierit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut i njihet e drejta që të paraqesë në Gjykatën e Strasburgut opinione, por njëkohësisht të dëgjohet në këtë gjykatë.

Së pesti, protokollin përcakton edhe rregullat procedurale nëse gjykata ka të drejtë në çdo rast kur i kërkon gjykata më e lartë e një vendi opinion apo jo. Në fakt, janë gjyqtarët e dhomës së madhe ata që vendosin nëse duhet apo jo të japin opinion, i cili është rekomandues, jo detyrues.

Së gjashti, gjykatat vendase kanë të drejtë të njihen me opinionin e shumicës dhe të pakicës së gjyqtarëve të dhomës së madhe.

Në fakt, protokollin ka lënë të hapura gjykatat e larta. Ne duhet të përcaktojmë nëse do t'i njihet kjo e drejtë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë apo edhe gjykatave të tjera. Nëse doni mendimin tim, unë sugjeroj se kjo e drejtë duhet t'i njihet Gjykatës Kushtetuese, që merret me kontrollin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Por shpeshherë Gjykata e

Lartë nëpërmjet vendimeve unifikuese unifikon praktikën. Pra, edhe kjo gjykatë merret me zbatimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo çështje në lihet neve në diskrecion dhe duhet sqaruar.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Eduard Halimi** – E vetmja gjë që mund të propozojmë ne është depozitimi i ndonjë instrumenti ratifikimi. Mirëpo përcaktimi i gjykatave nuk është instrument ratifikimi. Kështu që unë nuk besoj se ka hapësirë për këtë që kërkon ju.

**Fatmir Xhafaj** – Ne me ligj nuk e caktojmë dot këtë gjë.

**Eduard Halimi** – Ne nuk i japim dot rekomandime gjykatës si të na japë rekomandime neve.

**Vasilika Hysi** – Po si do ta bëjmë?

**Eduard Halimi** – Ose duhet ta ratifikojmë, ose duhet ta nënshkruajmë. Marrëveshjen nuk do ta nënshkruajmë, kështu që duhet të miratojmë një instrument tjetër nënshkrimi, që ne nuk e kemi. Këto janë modalitetet e konventës, po deshe nënshkruaji, po deshe mos i nënshkruaj. Kaq ka. Kështu që mundësi për t’ju rekomanduar atyre nuk kemi.

Unë besoj se kemi vetëm një moment, atë të nënshkrimit, jo sugjerim.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo përcaktohet në letrat e nënshkrimit ndërmjet palëve.

Zonja Treska, keni fjalën.

**Ketrin Treska** – Në fakt, në momentin e nënshkrimit nuk është bërë një përcaktim i tillë. Neni 10 i protokollit parashikon që në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, me anë të një deklarate drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, secila palë e lartë kontraktuese specifikon gjykatat ose tribunalet që cakton neni 1 i protokollit.

**Fatmir Xhafaj** – Kur të depozitoni ratifikimin, në deklaratën që do t’i drejtoni sekretarit të Përgjithshëm, përcaktoni edhe dy gjykatat.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Dakord.

Faleminderit!

Neni 1. Dakord?

Miratohet.

Neni 2. Dakord?

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit që ishit të pranishëm!

## **MBLEDHJA MBYLLET**